UDHËZIM
Nr. 10, datë 17.5.2021

PËR REGJISTRIMIN DHE MBËSHTETJEN NË INSTITUCIONET ARSIMORE PARAUNIVERSITARE PUBLIKE TË FËMIJËVE TË PERSONAVE NË SITUATË MIGRIMI/AZILI, REFUGJATË, TË FËMIJËVE TË HUAJ TË PASHOQËRUAR, TË FËMIJËVE QË KTHEHEN NGA EMIGRACIONI, NGA ZONAT E KONFLIKTIT APO FËMIJË, VIKTIMA TË TRAFIKIMIT, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 5 dhe të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
ARSIMIMI I FËMIJËVE TË PERSONAVE NË SITUATË MIGRIMI/AZILI, REFUGJATË APO TË FËMIJËVE TË HUAJ TË PASHOQËRUAR

1. Fëmijët e personave, të cilët janë në situatë migrimi/azili, refugjatë apo fëmijëve të huaj të pashoqëruar në Republikën e Shqipërisë, ndjekin arsimin parauniversitar me të njëjtat kushte, si edhe fëmijët me shtetësi shqiptare. Zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) përcaktojnë institucionet arsimore parauniversitare publike ku do të regjistrohen këta fëmijë.

2. Fëmijët e moshës 3–5 vjeç që nuk zotërojnë certifikatë lindjeje apo fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të regjistrohen në arsimin parashkollor, sipas deklarimit të prindërve/kujdestarit ligjor dhe dokumentacionit që fëmija zotëron nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

3. Nxënësit e moshës 6–21 vjeç, në situatë migrimi/azili, refugjatë, apo pa shtetësi, për të vazhduar mësimin në arsimin bazë ose arsimin e mesëm të lartë, paraqesin në ZVAP dëftesën/dëftesat origjinale të përkthyera dhe të noterizuara. ZVAP-ja bën ekuivalentimin e notave, siglon dëftesën e nxënësit dhe cakton institucionin arsimor parauniversitar publik ku do të vazhdojë mësimin nxënësi, sipas vendbanimit ku ai është vendosur:

a) në klasën pasardhëse, kur vjen në fillim të vitit shkollor;

b) në klasën përkatëse, kur vjen gjatë vitit shkollor.

4. Nxënësit që nuk provojnë me dokument zyrtar të shtetit nga vijnë, përfundimin apo vazhdimin e një klase, vlerësohen me testim, për shkallën e njohurive nga një komision ndërlëndor, i përbërë nga mësues dhe nga punonjësi i shërbimit psikosocial, që ngrihet në institucionin arsimor parauniversitar publik. Komisioni në bazë të vlerësimit cakton klasën ku nxënësit i përket të regjistrohet.

5. Institucioni arsimor parauniversitar publik trajton me plan individual për mësimin e gjuhës shqipe nxënësit e personave në situatë migrimi/azili, refugjatë apo fëmijëve të huaj të pashoqëruar.

6. Institucioni arsimor parauniversitar publik siguron tekstet shkollore për fëmijët e personave në situatë emigrimi/azili, refugjatë apo fëmijëve të huaj të pashoqëruar.

KREU II
ARSIMIMI I FËMIJËVE TË KTHYER NGA EMIGRACIONI

1. Pranimi dhe administrimi i kërkesave të prindërve dhe/ose i kujdestarëve ligjorë të fëmijëve të kthyer nga emigracioni dhe të dokumentacionit shkollor që ata disponojnë për regjistrimin e tyre në institucionet arsimore publike të sistemit parauniversitar bëhet nga ZVAP-ja.

2. Kërkesa për regjistrim shoqërohet, me:

a) certifikatën e lindjes së nxënësit;

b) dokumentet e shkollimit;

c) fotokopje e dokumentit, që pasqyron datën e rikthimit në Shqipëri të nxënësit.

3. Institucioni arsimor parauniversitar publik, i përcaktuar nga ZVAP-ja, ngre një komision ndërlëndor për fëmijët që kthehen nga emigracioni. Komisioni, mbështetur në vetëdeklarimin e prindërve/kujdestarëve ligjorë dhe në dokumentacionin e pikës 2, vlerëson me testim dhe cakton klasën ku nxënësit i përket të regjistrohet.

4. Punonjësi i shërbimit psikosocial në institucionin arsimor parauniversitar harton një plan të posaçëm pune për ofrimin e shërbimeve, që ndihmojnë në zhvillimin social dhe individual të nxënësve që kthehen nga emigracioni.

5. Institucioni arsimor parauniversitar publik ku regjistrohen nxënësit e kthyer nga emigracioni:

a) ofron kurse të gjuhës shqipe për nxënësit, pasi ata vlerësohen për njohuritë e tyre në këtë lëndë;

b) trajton me plane individuale mësimore, nxënësit e regjistruar, me qëllim që të plotësohen detyrimet e programeve lëndore për periudhën kohore të munguar prej tyre;

c) mundëson pajisjen e nxënësve të kthyer nga emigracioni me tekste shkollore.

KREU III
ARSIMIMI DHE RIINTEGRIMI I FËMIJËVE TË KTHYER NGA ZONAT E KONFLIKTIT

1. Pranimi dhe administrimi i kërkesave të prindërve dhe/ose i kujdestarëve ligjorë të fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit për regjistrimin e tyre në institucionet arsimore publike të sistemit parauniversitar bëhet nga ZVAP-ja.

2. ZVAP-ja njofton institucionin arsimor parauniversitar publik për regjistrimin dhe riintegrimin e fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit.

3. Institucioni arsimor parauniversitar publik, i përcaktuar nga ZVAP-ja, ngre një komision ndërlëndor të përbërë nga mësues dhe nga punonjës të shërbimit psikosocial për fëmijët e kthyer nga zonat e konfliktit, me qëllim:

a) vlerësimin e nevojave arsimore dhe të atyre psikosociale të këtyre fëmijëve;

b) përcaktimin e klasës ku fëmija do të regjistrohet. Në varësi të specifikave, fëmija regjistrohet në klasën me grup-moshë të njëjtë me moshën e tij ose një vit më pak se kjo grup-moshë.

4. Institucioni arsimor parauniversitar publik:

a) harton planin individual mësimor për fëmijët e kthyer nga zonat e konfliktit, duke u bazuar te raporti i vlerësimit të komisionit ndërlëndor;

b) ngre grupin e punës, i cili harton planin individual për riintegrimin e fëmijëve. Në këtë grup bën pjesë drejtori i shkollës, mësuesi kujdestar, psikologu i shkollës/punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe dy mësues lëndorë. Ky grup harton raporte 1-mujore mbi ecurinë e rastit dhe i përcjell ato në ZVAP-në përkatës;

c) siguron tekstet shkollore për fëmijët që kthehen nga zonat e konfliktit.

5. Regjistrimi i fëmijëve që kthehen nga zonat e konfliktit edhe në rastet kur ka mungesë dokumentacioni do të bëhet në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve.

KREU IV

ARSIMIMI I FËMIJËVE, VIKTIMA TË TRAFIKIMIT

1. Fëmijëve, viktima të trafikimit në moshën e detyrimit shkollor (6–16 vjeç), u sigurohen kushtet për ndjekjen e arsimit parauniversitar. ZVAP-ja, në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve, bazuar në dokumentacionin e disponueshëm, përcaktojnë institucionet arsimore parauniversitare publike ku ata do të regjistrohen.

2. Fëmijët, viktima të trafikimit, që nuk provojnë me dokument zyrtar përfundimin apo vazhdimin e një klase, provohen për shkallën e njohurive me testim nga një komision ndërlëndor të përbërë nga mësues dhe nga punonjësi i shërbimit psikosocial, që ngrihet në institucionin arsimor parauniversitar, përcaktuar nga ZVAP-ja. Komisioni vlerëson dhe cakton klasën ku nxënësit i përket të regjistrohet.

3. Punonjësi i shërbimit psikosocial në institucionin arsimor parauniversitar publik harton një plan të veçantë pune për mbështetjen, trajtimin dhe integrimin në shkollë të fëmijëve viktimave të trafikimit.

4. Institucioni arsimor parauniversitar publik siguron tekstet shkollore për fëmijët viktima të trafikimit që ndjekin arsimin parauniversitar.

KREU V
DISPOZITAT E FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 32, datë 26.10.2009, i ministrit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, "Për regjistrimin dhe vlerësimin e nxënësve që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë", shfuqizohet.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Evis Kushi